



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 746 Akti

Nr. 763 Vendimi
Tiranë, më 16.5.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine Kryesuese
Roland Ilia Relator
Genta Tafa (Bungo) Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 16.5.2024, ora 09:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Kaliona Nushi**, me detyrë këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, subjektin e rivlerësimit dhe vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Kaliona Nushi, e cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi, me detyrë këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në qershor të vitit 2021, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh komisioneri Roland Ilia dhe kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Xhensila Pine. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Kaliona Nushi, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit sipas kërkesës së Komisionit ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 8.5.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Kaliona Nushi; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit në datën 14.5.2024.
8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë znj. Kaliona Nushi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 14.5.2024.

9. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 16.5.2024, ora 09:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

10. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11. Znj. Kaliona Nushi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar.

Procesi i rivlerësimit/hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

12. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

13. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

14. Subjekti Kaliona Nushi ushtron detyrën e këshilltares pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë pa ndërprerje që nga viti 2007 (data e emërimit në detyrë 1.4.2007) dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar në përputhje me nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

14.1 Bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, subjekti Kaliona Nushi është me gjendje civile beqare dhe kryefamiljare.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

¹ 41. Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashkohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

15. Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Kaliona Nushi, ku konstatohet se:

- *ka pasaktësi në deklaratat e interesave privatë ndër vite dhe mosdeklarim pasurie;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit:

- Raportin e ardhur nga ILDKPKI-ja dhe dosjen për vlerësimin e pasurisë:

- ✓ deklaraten *Vetting* të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003;
- ✓ dokumentet e ndodhura në dosjen e dërguar nga ILDKPKI-ja;
- ✓ dokumentacionin e administruar nga institucionet publike dhe private sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016”;
- ✓ deklaratimet e subjektit dhe provat e dërguara në përgjigje të pyetësorëve.

- Raportin e administruar nga AKSIK-ja për kontrollin e figurës:

- ✓ formularin e plotësuar të kontrollit të figurës;
- ✓ hetimin administrativ të Komisionit.

- Raportin profesional të administruar nga KLGJ-ja, për vlerësimin profesional:

- ✓ dokumentet e ndodhura në dosjen e dërguar nga KLGJ-ja.

Në deklaratën e pasurisë, shtojca *, dorëzuar në ILDKPKI në datën 20.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka deklaruar:**

1. Shtëpi banimi/apartament

1.1 Subjekti ka deklaruar pasurinë apartament me sip. 43.8 m², në rrugën “****” (sipas certifikatës së pronësisë është rruga “****”), pallati ***, shkalla *** (sipas certifikatës së gjendjes civile, kurse sipas certifikatës së pasurisë dhe kontratës së shitblerjes është shkalla ***), Tiranë.

1.2 Sipas deklaratimit të subjektit kjo pasuri është blerë në vitin 2002, me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.2.2006 dhe e regjistruar në regjistrat e pasurisë së paluajtshme në datën 17.2.2006. Vlera: 2,900,000 lekë. Zotërimi: 50%.

1.3 Burimi i krijimit të pasurisë është deklaruar një hua në vlerën 1.400.000 lekë (shihni “Të dhënat konfidenciale”) dhe pjesa tjetër kursime të familjes.

1.4 ILDKPKI-ja ka konstatuar se subjekti nuk ka dokumentuar marrëdhënien e huas dhe nuk ka paraqitur gjeneralitetet e plota të huadhënësit të shumës 1,400,000 lekë (xhaxhait të saj), por huaja i përket periudhës para vitit 2007 (para fillimit të detyrës) dhe është marrë nga familjarët e saj.

Hetimi i Komisionit

1.5 ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 13.4.2018, dhe ASHK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 20.6.2023, ka konfirmuar se subjekti Kaliona Nushi ka të regjistruar në bashkëpronësi pasurinë nr. ***, e llojit apartament me sip. 43.8 m².

1.6 Kjo pasuri rezultoi e blerë nga shtetaset Kaliona dhe E.N (motra e saj) me anë të kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.2.2006 (pasuri e llojit apartament me sip. 43.8 m²). Vlera sipas kontratës është 2,900,000 lekë dhe palë shitëse rezultuan shtetasit Gj dhe R. L.

1.7 Bazuar në kontratën e shitjes palët kanë deklaruar se shuma 2,900,000 lekësh është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.8 Kjo pasuri e paluajtshme në bashkëpronësi rezultoi e blerë më 2.2.2006, para fillimit të detyrës si këshilltare pranë Gjykatës Kushtetuese (emërimi në detyrë 1.4.2007).

1.9 Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se nga fillimi i detyrës në Gjykatën Kushtetuese ka jetuar në këtë banesë në bashkëpronësi, të deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore.

1.10 Për këtë pasuri në bashkëpronësi është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie e datës 17.2.2006, në emër të shtetaseve E dhe Kaliona Nushi.

1.11 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (datë 27.4.2007) subjekti ka deklaruar: shtëpi banimi/apartament me sip. 43.8 m², rruga “****”, Tiranë, blerë më 2.2.2006. Burimi i krijimit: hua tek familjarët. Vlera: 2,900,000 lekë.

1.12 Lidhur me mospërputhjen e deklaramit të subjektit për burimin e krijimit të kësaj pasurie të deklaratës *Vetting* me deklaratën para fillimit të detyrës u pyet subjekti i rivlerësimit.

1.13 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti deklaroi se: *“Siç keni konstatuar, në deklaratën para fillimit të detyrës kam deklaruar si burim vetëm huan e marrë te familjarët. Ky deklaram është bërë prej meje duke konsideruar si detyrim vetëm deklaramin e burimit për pjesën time takuese të kësaj pasurie, pra për pjesën time prej 50% dhe jo për të gjithë pasurinë. Siç kam sqaruar në deklaratat e mëparshme të pasurisë (ajo e vitit 2008), në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësorin standard unë kam marrë përsipër dhe kam mbuluar pjesën më të madhe të këtij detyrimi, duke e konsideruar atë si detyrim timin personal, edhe pse prindërit dhe motra më kanë ndihmuar në vijim brenda mundësive të tyre, në mënyrë që ai të shlyhej në një kohë sa më të shpejtë”*.

1.14 FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2023, ka konfirmuar se për shtetasen Kaliona G Nushi, referuar të dhënave të sistemit të faturimit nuk rezulton të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal sh. a., pjesë e grupit OSHEE.

1.15 Ujësjellës Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 14.6.2023, ka konfirmuar se në emër të znj. Kaliona Nushi rezulton kontrata me nr. *** për objektin në rrugën “ *** ”, me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë.

Lidhur me burimin e blerjes së kësaj pasurie

1.16 Pavarësisht faktit se kjo pasuri është blerë nga subjekti para detyrës, Komisioni hetoi lidhur me burimin e blerjes së saj, pasi kjo pasuri rezultoi si pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting*.

1.17 Subjekti ka deklaruar se burim për blerjen e kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat nga kursimet e familjes dhe huaja e marrë nga shtetasi Gj.N, në vlerën 1,400,000 lekë.

1.18 Në deklaratën *Vetting*, te rubrika “Të dhënat konfidenciale” subjekti ka deklaruar: “*Huaja në vlerën 1,400,000 lekë është marrë nga familja tek xhaxhai im Gj.T.N, i cili aktualisht jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shumë e krijuar nga të ardhurat e familjes së tij. Ky detyrim është shlyer tërësisht nga kursimet personale dhe të familjes*”.

1.19 Kjo pasuri rezultoi se është në bashkëpronësi të subjektit dhe motrës së saj E.N dhe lidhur me kontributin e tyre financiar si bashkëpronarë për këtë pasuri u pyet subjekti i rivlerësimit.

1.20 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti deklaroi se: “*Unë jam bashkëpronare me motrën time në këtë pasuri apartament, e cila është blerë në vitin 2006, pra para fillimit të detyrës në Gjykatën Kushtetuese. Burimi për blerjen e kësaj pasurie është huaja e marrë te xhaxhai im dhe pjesa tjetër kursime të familjes. Lidhur me kontributin e motrës sime ai ka si burim kursimet familjare, pasi prindërit e mi kanë pasur dëshirën që vajzat e tyre me qëndrim në Tiranë në atë kohë të kishin një shtëpi të tyre. Pjesë e këtyre kursimeve kanë qenë edhe të ardhurat e mia, pasi në atë kohë një pjesë të pagës unë e depozitoja te prindërit e mi, si burim i të ardhurave familjare*”.

- Nisur nga: (i) deklarimi i mësipërm i subjektit në lidhje me kontributin e saj në kursimet familjare; (ii) fakti që subjekti ka qenë në të njëjtin trung familjar me familjen e origjinës², subjekti është analizuar së bashku me familjen e saj deri në momentin e blerjes së apartamentit datë 2.2.2006.

Lidhur me të ardhurat nga kursimet familjare

1.21 Nisur nga deklarimi i subjektit se 1,400,000 lekë për blerjen e pasurisë apartament janë marrë hua, vlera dhe kontributi i subjektit dhe familjarëve për blerjen e kësaj pasurie duket se ka qenë në shumën 1,500,000 lekë (vlera e pasurisë 2,900,000 – 1,400,000 = 1,500,000 lekë).

1.22 Komisioni pyeti subjektin lidhur me burimin e krijimit të kursimeve të familjes që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

1.23 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti deklaroi se: “*Burimi i krijimit të kursimeve të familjes që kanë shërbyer pjesërisht për blerjen e pasurisë kanë qenë nga të ardhurat nga punësimi. Në lidhje me sa kërkohet të provohet, ju lutem gjeni edhe një herë bashkëlidhur vërtetimin e pagës të lëshuar nga institucioni ku kam qenë e punësuar në atë kohë për të ardhurat e mia që prej fillimit të detyrës dhe deri në vitin 2006, si dhe dokumentacionin që provon të ardhurat e prindërve të mi ndër vite, sipas vërtetimeve të Institutit Rajonal të Sigurimeve Shoqërore Fier, mbi bazën e të cilave u është caktuar atyre pensioni i pleqërisë*”.

1.24 Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, lidhur me të ardhurat e babait të saj subjekti ka deklaruar se: “*Në lidhje me të ardhurat e familjes sime, përveç dokumentacionit provues të paraqitur pranë jush, dua të sqaroj se edhe pse im atë nuk ka mundur të sigurojë dokumentacion provues, ai ka punuar deri në momentin e daljes në pension dhe ka siguruar të ardhura për familjen. Në vitet 1993 – 1995 ai ka punuar si emigrant në Greqi dhe më pas ka hapur një aktivitet privat bar-kafe. Pas viteve 2000 ai ka pasur një pikë duralumini ku ka ushtruar aktivitetin. Për shkak se dokumentacioni i kohës që provonte pagesat vullnetare të sigurimeve shoqërore nuk u arrit të gjendej në kohën që ai paraqiti kërkesën për përfitim të*

² Subjekti është shkëputur nga trungu familjar në datën 11.10.2007 ose 6 muaj pas fillimit të detyrës si këshilltare ligjore.

pensionit të pleqërisë, situata faktike që kam deklaruar më sipër nuk është reflektuar në përlllogaritjen e pensionit të tij të pleqërisë.

Megjithatë, nga dokumentet që ka pasur në ruajtje familja ime ju paraqes bashkëlidhur disa fatura të energjisë elektrike që i referohen objektit ku ushtronte veprimtarinë im atë, në të cilat rezulton adresa dhe lloji i veprimtarisë që ai ushtronte, si edhe procesverbali i mbajtur nga CEZ për mbylljen e kontratës së furnizimit me energji elektrike për subjektin privat”.

1.25 Subjekti në përgjigjet e dërguara mbi pyetësorin nuk ka përcaktuar qartë dhe saktë vlera monetare të fituara nga babai i saj. Gjithashtu, subjekti nuk ka mundur të provojë: (i) të ardhura të babait nga emigracioni në Greqi; (ii) të ardhura për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore nga ushtrimi i aktivitetit të tij privat në Shqipëri. Për këtë arsye, të ardhurat e babait të pretenduara nga subjekti nuk janë konsideruar nga Komisioni në analizën financiare të familjes.

1.26 Komisioni hartoi analizën financiare lidhur me mundësitë e subjektit dhe familjarëve të saj për përballimin e shumës prej 1,500,000 lekësh, shumë e cila ka shërbyer për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2006.

Analiza e mundësisë financiare të subjektit dhe familjarëve të saj

1.27 Komisioni, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, ka kryer analizën financiare duke përdorur metodologjinë kumulative, pasi periudha e analizuar i takon asaj para emërimit në detyrë të subjektit. Sipas kësaj analize, subjekti dhe prindërit e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kursimin dhe pagesën e shumës 1,5 milionë lekë deri në datën e blerjes së apartamentit, sikurse është treguar në tabelën nr. 1.

Tabela nr. 1

Përshkrimi	Periudha 1993 – 2.2.2006
Pasuri	3,019,455
Apartament me sip. 60 m ² , Lushnjë, b/pronare me prindërit me privatizim	5,220
Apartament me sip. 43.8 m ² , rr. “***”, Tiranë, datë 2.2.2006	2,900,000
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>114,235</i>
Detyrime	1,400,000
Hua marrë nga prindërit tek xhaxhai Gj.N datë 25.1.2006	1,400,000
Pasuri neto	1,619,455
Të ardhura dokumentuar	6,062,655
Të ardhura nga paga e subjektit nga data 16.8.2001	1,773,688
Të ardhura nga babai në vitet 1993 – 1996	89,308
Të ardhura nga nëna nga viti 1993 e në vijim	4,199,659
SHPENZIME	4,231,587
Shpenzime jetese për 4 persona	3,421,547
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS	185,040
Pagesa për qiranë e apartamentit në Tiranë	625,000
Mundësia për kursime	211,613

1.28 Në këtë analizë janë marrë në konsideratë:

- Të ardhurat e nënës së subjektit nga prilli 1993 e në vijim; të ardhura të babait për periudhën shtator 1993 – dhjetor 1996; të ardhura të subjektit nga data 16.8.2001 kur ajo ka filluar punë si specialiste në Gjykatën e Lartë.

- Shpenzimet e jetesës deri në fund të vitit 1999 janë konsideruar si 66% e të ardhurave familjare dhe nga viti 2000 e në vijim janë përlllogaritur për 4 persona³ sipas standardit të ILDKPKI-së.

1.29 Për sa më sipër, duket se subjekti dhe familjarët e saj kanë pasur mundësi financiare dhe të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kursimin dhe pagesën e shumës 1,5 milionë lekë deri në datën e blerjes së apartamentit.

Lidhur me mundësitë financiare të huadhënësit

1.30 Bazuar në deklarinimin e subjektit Komisioni hetoi lidhur me mundësitë financiare të huadhënësit për dhënien e shumës 1,400,000 lekë subjektit të rivlerësimit në vitin 2006.

1.31 Lidhur me mundësitë financiare të huadhënësit, shtetasit Gj.N , u pyet subjekti i rivlerësimit, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. *** deklaroi se: *“Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit kam deklaruar se xhaxhai im ka pasur të ardhura nga: (i) punësimi në Shqipëri; (ii) shitja e pasurisë apartament në pronësi në qytetin e Beratit në vlerën 1,000,000 lekë, kursime këto të mbajtura në Shqipëri; (iii) punësimi në shtetin grek ku ka jetuar dhe punuar që prej vitit 1997.*

Për të provuar sa më sipër, bashkëlidhur pyetësorit standard kam paraqitur si dokument provues kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme në pronësi të xhaxhait tim, e datës 22.1.1996 dhe dokumentet e viteve financiare 2005 dhe 2006 të deklarinimit të të ardhurave të tatueshme në shtetin grek, të nxjerra nga sistemi “webtax”, të përkthyer dhe të noterizuara. Sipas legjislacionit të shtetit grek, ashtu si edhe legjislacioni shqiptar, por edhe referuar datës në të cilën janë lëshuar këto deklarata, ato përbëjnë deklarime të të ardhurave të subjektit deklarues të vitit paraardhës, përkatësisht të viteve 2004 dhe 2005, deklarime që plotësohen dhe mbyllen në vitin pasardhës tatimor”.

1.32 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka bashkëlidhur DVAP⁴ të Gj.N për vitet 2004 dhe 2005. Sipas këtyre deklaratave të të ardhurave vjetore rezulton se të dy bashkëshortët kanë përfituar të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, pra, ato kanë pasur të ardhura të ligjshme.

1.33 Subjekti është pyetur lidhur me disponimin e shumës prej 1 milion lekësh nga viti 1996 e në vazhdim. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar se kjo shumë e përfituar nga shitja e shtëpisë së tij në Berat, por edhe nga kursime të tjera nga puna në Shqipëri deri përpara largimit në Greqi, si dhe të ardhurat e krijuara nga puna në emigracion në Greqi pas vitit 1997 ia ka lënë në ruajtje vëllait të tij/babait të subjektit. Subjekti ka deklaruar se: *“Përgjatë kohës që xhaxhai ka qenë emigrant i ligjshëm në shtetin grek ai ka sjellë ose ka dërguar në një periudhë të shtrirë në kohë lekë nga punësimi në shtetin grek, pasi ka pasur si qëllim investimin e tyre në Shqipëri”.*

³ Prindërit, subjekti dhe motra e saj.

⁴ DVAP është analoge me deklaratën DIVA; ajo është detyrim të dorëzohet në Zyrën e Tatimeve D.O.Y. për çdo shtetas dhe rezident në shtetin grek, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe përfiton çdo lloj të ardhure në këtë shtet (http://www.***.eu/***-***/). DVAP plotësohet për familjen (burrë-grua) dhe fëmijët e varur ekonomikisht.

1.34 Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti ka paraqitur edhe një certifikatë familjare të xhaxhait të saj nga e cila ka rezultuar se ai jeton vetëm me bashkëshorten e tij, fakt i cili reflektohet edhe në deklaratat e të ardhurave në shtetin grek.

1.35 Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ u evidentua se subjekti ka çelur një llogari bankare pranë Bankës Italo-Shqiptare⁵, duke depozituar në të shumën 12,600 USD në datën 5.12.2003. Në datën 5.1.2004 subjekti ka shtuar edhe shumën 2,710 USD dhe totali i përfutur prej 15.310 USD është investuar në depozita me afat 1-mujore deri në datën 6.6.2005. Për këtë u pyet subjekti mbi: (i) burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj depozite; dhe (ii) destinacionin e përdorimit të saj, pas tërheqjeve të kryera.

1.36 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar se këto shuma kanë qenë kursime të xhaxhait të saj, duke theksuar se: *“Në fund të vitit 2003, nga shuma që im atë ka pasur në ruajtje në atë kohë, për një pjesë të tyre xhaxhai më autorizoi që unë t'i depozitoja në bankë dhe me porosi dhe për llogari të tij unë kam hapur një llogari bankare pranë Bankës Italo-Shqiptare ku kam derdhur shumën e kërkuar prej tij dhe konkretisht: shumën 12,600 USD apo ekuivalent të përafërt prej 1,350,000 lekësh, derdhur në dhjetor të vitit 2003; shumën 2,710 USD apo ekuivalent të përafërt prej 300,000 lekësh, derdhur në janar të vitit 2004”.*

1.37 Për sa i takon destinacionit të përdorimit të këtyre shumave, subjekti ka vijuar të deklarojë se: *“Pasi xhaxhai ra dakord për dhënien e huas, në janar të vitit 2006, me miratimin e tij unë kam tërhequr nga llogaria bankare shumën 7,200 USD apo ekuivalente e përafërt e shumës 750,000 lekë dhe për pjesën tjetër të huas ai autorizoi që të përdornim nga shuma që im atë kishte gjendje cash në ruajtje në shtëpi nga të ardhurat që xhaxhai kishte sjellë në Shqipëri. Shuma prej 7,200 USD apo ekuivalente e përafërt e shumës 750,000 lekë është tërhequr në janar të vitit 2006, me qëllim përdorimin për blerjen e apartamentit në bashkëpronësi; shuma prej 8,616 USD është tërhequr kur më është kërkuar nga xhaxhai”.*

1.38 Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. *** edhe ekstraktin bankar nga Banka Italo-Shqiptare për periudhën 5.12.2003 – 5.7.2006, në të cilën pasqyrohen të plotë të gjitha veprimet e kryera në të deri në momentin që kjo llogari është mbyllur.

1.39 Deklarimet e mësipërme të subjektit përputhen me lëvizjet bankare; ato duken bindëse dhe përbëjnë sqarime më të hollësishme të deklaratimeve të saj të mëparshme. Kështu, shuma 15,705.43 USD, e ndodhur në Bankën Italo-Shqiptare në datën 31.12.2005, është konsideruar si pasuri e xhaxhait të subjektit dhe jo e saj dhe e familjes së saj dhe këto likuiditete janë përfshirë në analizën financiare lidhur me mundësitë e huadhënësit Gj.N .

Analiza financiare e huadhënësit Gj.N

1.40 Për të verifikuar mundësinë e xhaxhait të subjektit për të dhënë hua shumën 1.4 milionë lekë deri në datën 25.1.2006, Komisioni ka kryer analizën financiare bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet e tij për vitet 2004 – 2005.

⁵ Shihni shkresën kthim përgjigje të ISP Bank, me nr. *** prot., datë 31.5.2023, në dosjen e Komisionit.

Tabela nr. 2

Huadhënësi Gj.N (në lekë)	2004 dhe 2005
Të ardhura të dokumentuara	5,250,297
Të ardhura familjare Gj.N në Greqi	4,170,088
Kthim i tatimeve nga shteti grek	57,399
Shitja e shtëpisë në Berat 22.1.1996 (para në ruajtje)	1,000,000
Interesa të përfituar nga depozita në Bankën Amerikane	22,810
Shpenzime të dokumentuara	4,456,004
Shpenzimet e jetesës për 2 persona	1,433,162
Likuiditete në BIA Shqipëri	1,622,842
Huaja e dhënë tek subjekti deri më 25.1.2006	1,400,000
Mundësia për kursime	794,293

1.41 Në analizë është përfshirë si e ardhur vlera e përfituar nga shitja e apartamentit në Berat në vitin 1996, e lënë në ruajtje tek babai i subjektit.

Gjithashtu është konsideruar si pasuri e tij vlera e depozitave në Bankën Italo-Shqiptare.

Sipas kësaj analize, treguar në tabelën nr. 2, xhaxhai i subjektit ka pasur mundësinë për të dhënë huan në këtë shumë në janar të vitit 2006.

Lidhur me shlyerjen e huas prej 1,400,000 lekësh

1.42 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se shumën e huas prej 1,400,000 lekësh e ka shlyer totalisht.

1.43 Bazuar në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, rezultoi se detyrimi prej 1,400,000 lekësh ndaj xhaxhait është shlyer në vitin 2008.

1.44 Në deklaratën periodike për vitin 2008 subjekti ka deklaruar: *“Në lidhje me pasurinë e deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 ju sqarohet: Burimi i krijimit të kësaj pasurie ku unë jam bashkëpronare me motrën është 1,400,000 lekë hua pa interes e marrë nga prindërit të xhaxhai im Gj.N, kurse pjesa tjetër ishin kursime të familjes sime. Kjo hua është shlyer plotësisht nga familja. Pjesa e mbetur e saj në shumën 400,000 lekë është shlyer prej meje me shumën e marrë kredi nga Credins Bank edhe pse kjo kredi u mor fillimisht për mobilimin e shtëpisë”*.

1.45 E pyetur për kohën dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për kthimin e huas, në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka deklaruar se: *“Për sa i përket shlyerjes së huas ajo është shlyer përkatësisht:*

- nga të ardhurat e mia dhe të familjes sime përgjatë vitit 2007 për shumën 800,000 lekë, shumë që me sa na kujtohet u është dhënë personalisht;
- nga të ardhurat e mia përgjatë vitit 2008 dhe pjesërisht nga kredia e marrë prej meje për shumën e mbetur 600,000 lekë, që me sa na kujtohet u është dërguar me persona të tretë të besuar që udhëtonin drejt Greqisë”.

1.46 Bazuar në deklaratimet e subjektit, pasqyrimi në analizën financiare i shlyerjes së huas ndaj xhaxhait është konsideruar sikurse specifikuar në pyetësorin nr. ***.

1.47 Bashkëlidhur pyetësorit standard, subjekti ka paraqitur së bashku me të ardhurat e xhaxhait në shtetin grek edhe një deklaratë dore të nënshkruar prej tij në datën 30.10.2008, sipas së cilës ai deklaroi se huaja ndaj tij është shlyer plotësisht.

1.48 Komisioni konstatoi se në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës dhe atë periodike të vitit 2007, subjekti nuk ka deklaruar detyrimet financiare ndaj palës huadhënëse dhe për këtë pyeti subjektin e rivlerësimit.

1.49 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti deklaroi se: *“Në lidhje me sa më sipër, konstatimi juaj është i saktë dhe kjo ka ardhur për shkak të pakujdesisë nga ana ime në plotësimin e deklaratave të pasurisë. Në deklaratën para fillimit të detyrës e kam konsideruar të përmbushur detyrimin për sa kohë kam deklaruar huan si burim të krijimit të pjesës time të pasurisë. Ndërkohë që në deklaratën vjetore të pasurisë për vitin 2008 kam korrigjuar pasaktësinë duke deklaruar dhe saktësuar se detyrimi ishte shlyer tërësisht dhe se gjendja e mbetur e tij ishte “zero”. Në deklaratat e tjera të pasurisë, ajo për fillimin e detyrës dhe ajo e vitit 2007, pjesa e mbetur e detyrimit dhe pjesa e shlyer nuk janë deklaruar vetëm për shkak të pakujdesisë së treguar nga ana ime në plotësimin e tyre”.*

1.50 Gjithashtu, në lidhje me marrjen e kredisë bankare në vlerën 400,000 lekë subjekti deklaroi⁶ se: *“Siç keni konstatuar në lidhje me këtë kredi dhe siç unë kam deklaruar, ajo është marrë prej meje me qëllim mobilimin e shtëpisë. Megjithatë, në atë kohë nga ana e xhaxhait është kërkuar shlyerja e pjesës së mbetur të detyrimit për nevoja të familjes së tij. E ndodhur në këtë situatë dhe në mungesë të të ardhurave të tjera, vlerësova që ta përdorja këtë shumë të marrë kredi për qëllime të shlyerjes së huas. Nuk kam dokumentacion provues në lidhje me sa kam deklaruar më sipër”.*

1.51 Lidhur me mundësitë financiare për shlyerjen e huas, Komisioni hartoi analizën financiare si më poshtë.

Analiza financiare lidhur me shlyerjen e huas

1.52 Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësinë e familjes së subjektit për të shlyer shumën 800,000 lekë deri në fund të vitit 2007, duke përdorur metodologjinë kumulative.

1.53 Meqenëse: (i) pas fillimit të detyrës subjekti ishte shkëputur nga trangu familjar, duke mos qenë pjesë në certifikatën familjare me familjen e origjinës; si dhe (ii) gjatë periudhës së detyrës ajo pretendoi se nuk kishte kontribuar në shlyerjen e shumës 800,000 lekë, në analizën financiare subjekti është e përfshirë deri në fund të muajit mars të vitit 2007.

Tabela nr. 3

Përshkrimi	<i>Nga data 2.2.2006 deri në fund 2007</i>
Pasuri	614,903
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>614,903</i>
Detyrime	-800,000
Hua paguar nga prindërit tek xhaxhai Gj.N	- 800,000
Pasuri Neto	614,903
Të ardhura dokumentuar	1,781,406
Të ardhura nga paga e subjektit për periudhën 16.8.2001 – 31.3.2007	529,632
Të ardhura nga nëna nga viti 1993 e në vijim	1,040,161

⁶ Shihni përgjigjen e subjektit mbi pyetësorin nr. ***.

Të ardhura nga periudha të kaluara (1993 – 2.2.2006)	211,613
Shpenzime	608,677
Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare	608,677
Mundësia për kursime	557,826

1.54 Sipas kësaj analize, familja e subjektit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e një pjese të huas në shumën 15 milionë lekë deri në datën 30.10.2008, sikurse treguar në tabelën nr. 3.

1.55 Periudha e analizuar fillon pas blerjes së apartamentit, datë 2.2.2006, dhe shtrihet deri në fund të vitit 2007. Në këtë analizë janë konsideruar:

- Të ardhurat e dokumentuara për këtë periudhë të nënës dhe babait të subjektit; në këtë analizë është përfshirë si e ardhur “Mundësia për kursime” e rezultuar nga analiza e kryer për periudhën 1993 – 2.2.2006, sikurse trajtuar në çështjen 1.27/tabela nr. 1 e këtyre rezultateve.
- Shpenzimet e jetesës janë përllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së, për 3 persona për periudhën janar 2006 – 30.3.2007⁷ dhe duke filluar nga data 1.4.2007 vetëm për prindërit e subjektit.

1.56 Në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhurat dhe as shpenzimet e motrës së subjektit, duke konsideruar që ajo ka përballuar jetesën vetë⁸. Kjo konsideratë bazohet në deklaratimet e subjektit nga të cilat nuk rezulton asnjë kontribut i motrës në krijimin e kursimeve familjare për shlyerjen e huas tek xhaxhai.

1.57 Sa i takon shlyerjes tek xhaxhai të shumës 400,000 lekë, duke përdorur kredinë bankare të marrë pranë Credins Bank, është evidentuar se:

- kredia është disbursuar në datën 13.10.2008 në shumën 400,000 lekë;
- pas mbajtjes së komisioneve dhe shpenzimeve lidhur me kredinë nga ana e bankës, subjekti ka tërhequr *cash* shumën 389,000 lekë.

Pavarësisht qëllimit për të cilin është kërkuar kjo kredi, e cila në fakt është një kredi konsumatore⁹, shpjegimet e subjektit se ajo është përdorur për t’iu dhënë xhaxhait të saj, duken bindëse, pasi koha e disbursimit dhe e tërheqjes së shumës janë të përafërta me deklaratimin e xhaxhait për marrjen mbrapsht të huas së dhënë, në datën 30.10.2008.

1.58 Ndërsa shuma prej 200,000 lekësh është deklaruar prej subjektit si e shlyer me të ardhurat e saj gjatë vitit 2008. Nga analiza financiare e këtij viti ka rezultuar se subjekti e ka pasur mundësinë të kursejë shumën e mësipërme për të shlyer tek xhaxhai i saj shumën e mbetur të huas prej 600,000 lekësh.

Shlyerja e shumës 600,000 lekë nga ana e subjektit rezultoi me burim të ligjshëm.

1.59 Lidhur me shpenzimet e mobilimit për apartamentin objekt shqyrtimi, Komisioni shqyrtoi deklaratimet e bëra nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard (Pyetja 14), sipas të cilave këto shpenzime kanë filluar të bëhen nga viti 2010 e në vijim dhe janë të total në shumën 300,000 lekë¹⁰.

⁷ Subjekti dhe prindërit e saj.

⁸ Motra e subjektit ka filluar të punojë dhe të gjenerojë të ardhura nga marsi i vitit 2006.

⁹ Sipas dokumentit “Plan pagesash” të përcjellë nga Credins Bank, evidentohet që produkti i kredisë emërtohet kredi standarde në lekë.

¹⁰ Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 15, në pyetësorin standard.

1.60 Në këtë pyetësor, subjekti gjithashtu sqaron se ajo ka banuar në apartamentin që më vonë është blerë për të dhe motrën e saj, qysh në vitin 2001 dhe se ky apartament ka qenë i mobiluar. Nga ana tjetër, fakti që subjekti ka kërkuar nga Credins Bank shumën 400,000 lekë për mobilim shtëpie provon se kjo ka qenë nevoja e subjektit për mobilim.

1.61 Në këto kushte, Komisioni vlerësoi që koha e kryerjes së shpenzimeve të mobilimit të është periudha 2008 (blerja e televizorit tek *** nëpërmjet RZB Bank) – 2013, sikurse deklaruar nga subjekti në pyetësorin standard.

Vlera totale e këtyre shpenzimeve është konsideruar shuma 400,000 lekë.

1.62 Bazuar në deklaratimet e subjektit, ajo është pyetur mbi qiranë e paguar për apartamentin, i cili është blerë më vonë në vitin 2006.

1.63 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti deklaroi: *“Prej momentit të fillimit të punës në qytetin e Tiranës unë kam jetuar në apartamentin që aktualisht kam në bashkëpronësi. Fillimisht kam jetuar aty me motrën time, e cila në atë kohë ishte studente dhe në vitin 2002 ka ardhur të jetojë me ne edhe vajza e dajës sime (familja e saj jetonte në Lushnjë), për arsye se edhe ajo filloi studimet e larta në U.T. Që prej këtij viti dhe deri në vitin 2006, kohë gjatë së cilës motra dhe vajza e dajës kryenin studimet e larta, ne kemi jetuar së bashku në këtë apartament.*

Vlera e qirasë ka qenë 15,000 lekë/muaj dhe ajo nuk ka ndryshuar përgjatë gjithë periudhës që kemi jetuar në këtë apartament si qiramarrëse. Gjatë kohës që kam jetuar vetëm me motrën time vlera e qirasë është mbuluar nga të ardhurat e familjes sime, në të cilat përfshiheshin edhe të ardhurat e mia. Prej vitit 2002 dhe deri në fund të vitit 2005 pjesa jonë e qirasë është përgjysmuar dhe daja im ka paguar gjysmën e vlerës së qirasë mujore. Pasi pronarët e nxorën në shitje apartamentin, familja ime filloi bisedimet për blerjen e tij dhe në janar të vitit 2006 ramë dakord parimisht për blerjen e tij. Për vitin 2006 ne nuk kemi paguar qira.

Pronarët e apartamentit jetonin në shtetin grek dhe unë e familjarët e mi i kemi takuar personalisht kur ata erdhën në Shqipëri për lidhjen e kontratës së shitblerjes. Për apartamentin dhe qiranë kujdeseshin prindërit e njërit prej tyre, të cilët jetonin në qytetin e Vlorës dhe im atë kujdesej që t’u dërgonte atje vlerën mujore të qirasë, pagesë e cila kryhej në formën cash. Sqaroj se ne nuk kemi pasur kontratë qiraje në formë shkresore për banesën e marrë me qira”.

1.64 Vlera prej 15,000 lekësh/muaj është përfshirë në analizën financiare të subjektit dhe familjes së saj duke filluar nga gushti 2001 dhe deri në fund të vitit 2002 e, pas kësaj periudhe, vlera e qirasë mujore e paguar nga subjekti dhe familja e saj është konsideruar sa 2/3 e vlerës totale të qirasë deri sa apartamenti është ndarë nga 3 persona.

1.65 E pyetur mbi mënyrën e menaxhimit të bashkëpronësisë së apartamentit me motrën e saj, ndërkohë që duket se apartamenti i përbashkët posedohet vetëm nga subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. *** ajo është përgjigjur se: *“Për sa i përket asaj çka kërkoni për marrëdhënien e bashkëpronësisë me motrën time, edhe pse aktualisht nuk jeton me mua (motra është e martuar) ajo është pronare e kësaj pasurie në 50% dhe mes nesh nuk ka pasur ndonjë marrëveshje për menaxhimin e bashkëpronësisë. Ajo ka çdo të drejtë që i buron nga bashkëpronësia.*

1.66 Në përfundim të hetimit, lidhur me këtë pasuri Komisioni nuk konstatoi problematika.

Subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe ajo dhe familja e saj e origjinës kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie dhe shlyerjen e detyrimeve.

2. Gjendje *cash*

2.1 Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* të krijuar nga kursimet personale, nga të ardhurat nga paga dhe angazhime të tjera. Vlera: 800,000 lekë. Zotërimi: 100%.

2.2 Komisioni hetoi lidhur me deklaramet e bëra ndër vite lidhur me gjendjen *cash* dhe ndryshimet e saj (shtesa ose pakësime).

2.3 Rezultoi se për herë të parë subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në deklaramtën e pasurisë për vitin 2012 në shumën 400,000 lekë.

2.4 Në deklaramtat e pasurisë për vitet 2013 – 2015 nuk ka deklarime lidhur me gjendjen *cash*.

2.5 Në deklaramtën e pasurisë për vitin 2016 subjekti ka deklaruar: “Gjendje *cash* e krijuar nga kursimet personale nga të ardhurat në shumën 400,000 lekë”.

2.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar: “Në deklaramtën vjetore për vitin 2012, e dorëzuar në ILDKPKI më 28.3.2013, unë kam deklaruar gjendje *cash* në vlerën 400,000 lekë, që i përket gjendjes së krijuar me të ardhurat e vitit 2012. Në deklaramtën vjetore për vitin 2016, e dorëzuar në ILDKPKI më 20.3.2017, kam deklaruar gjendje *cash* në shumën 400,000 lekë, që i përket gjendjes së krijuar me të ardhurat e vitit 2016. Në deklaramtën Vetting, edhe pse ajo është dorëzuar para dorëzimit të deklaramtës vjetore, për sa kohë që përfshihej deklarimi i pasurisë së krijuar deri në atë moment (pra edhe viti 2016, pasuri që gjithashtu do të deklarohet edhe në deklaramtën vjetore), kam deklaruar të gjithë gjendjen *cash* të krijuar prej meje ndër vite, ku përfshihet gjendja *cash* e krijuar në vitin 2012, ashtu edhe ajo e krijuar në vitin 2016, pra shumatorja e tyre”.

2.7 Nga deklaramet periodike vjetore, por edhe nga shpjegimet e dhëna nga subjekti në pyetësorin nr. 2, gjendja e kursimeve *cash* ndër vite është paraqitur në tabelën nr. 4. Lidhur me mundësitë financiare për krijimin e gjendjes *cash* dhe ndryshimet ndër vite ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i krijuar këto kursime, sikurse është paraqitur në analizën financiare për periudhën e rivlerësimit, në pikën 8 të këtij vendimi.

Tabela nr. 4

<i>DIPP-të</i>	<i>Cash deklaruar (lek)</i>	<i>Me fjalë</i>	<i>Gjendja 31 Dhjetor</i>
2012	400.000	<i>Gjendje cash e krijuar nga kursimet personale nga të ardhurat nga pagat</i>	400.000
2013	-		400.000
2014	-		400.000
2015	-		400.000
2016	400.000	<i>Gjendje cash e krijuar nga kursimet personale nga të ardhurat</i>	800.000
D. Vetting	800.000	<i>Gjendje cash e krijuar nga kursimet personale nga të ardhurat nga paga dhe angazhime të tjera</i>	800.000

2.8 Në përfundim të hetimit, në lidhje me kursimet *cash* ndër vite, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i krijuar këto kursime.

3. Të ardhurat

3.1 Subjekti ka deklaruar dhe ka renditur të ardhurat e përfituara ndër vite.

3.2 Të ardhurat nga paga si specialiste pranë Gjykatës së Lartë për periudhën 16.8.2001 – 1.4.2007. Shuma: 2,303,320 lekë.

3.3 Të ardhurat nga paga si këshilltore e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 1.4.2007 – 31.12.2016. Shuma: 10,617,135 lekë.

3.4 Të ardhurat nga pjesëmarrja në Konferencën Rajonale me temë: “Institucionet e Avokatit të Popullit dhe gjyqësori për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut – Praktika më e mirë evropiane dhe eksperiencia rajonale”, e mbajtur në Prishtinë, Kosovë, në dhjetor 2013. Konferenca është organizuar nga Këshilli i Evropës. Pagesa për pjesëmarrjen në konferencë është bërë në cilësinë e ekspertes dhe referueses. Shuma: 587,50 euro.

3.5 Të ardhurat nga pjesëmarrja në Komisionin e Reformës në Drejtësi, si pjesë e Sekretariatit Teknik. Shuma: 428,440 lekë.

3.6 Të ardhurat nga pagesa si autore e shkrimit të botuar në revistën e Shkollës së Magjistraturës “****”, nr. ***, mars 2015. Shuma: 20,196 lekë.

3.7 Të ardhurat e deklaruara nga subjekti dhe të konfirmuara nga institucionet shtetërore për të cilat janë paguar dhe detyrimet tatimore janë përfshirë në analizën financiare sipas viteve përkatëse.

3.8 Në përfundim të hetimit në lidhje me të ardhurat nga pagat dhe angazhimet e tjera, Komisioni arriti në konkluzionin se deklaramet e subjektit janë të sakta.

4. Kontratë huaje në llogarinë rrjedhëse

4.1 Subjekti ka deklaruar kontratë huaje (fleks i kredi – *overdraft*), të lidhur më 3.11.2011 në vlerën 280,000 lekë. Interesi: tribor 1-vjeçar ditën e disbursimit +10.1% në vit. Shuma e detyrimit 191,874.72 lekë.

4.2 Bazuar në ekstraktin “Nxjerrje llogarie” nga Raiffeisen Bank, datë 24.10.2016 dhe datë 20.1.2017, për llogari në emër të znj. Kaliona Nushi me gjendje në datën 20.1.2017 me vlerë – 191,874 lekë.

4.3 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2017, konfirmoi llogari page në emër të znj. Kaliona Nushi, me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën – (minus) 182,414.72 lekë, me limit *overdraft* 280,000 lekë.

4.4 Deklarimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti është i saktë dhe përputhet me përgjigjen e Raiffeisen Bank.

4.5 Në përfundim të hetimit nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

5. Hua në vlerën 1,400,000 lekë

5.1 Sipas deklarimit të subjektit kjo hua është marrë nga familja tek xhaxhai Gj.T.N, i cili aktualisht jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shumë e krijuar nga të ardhurat e familjes së tij. Ky detyrim është shlyer tërësisht nga kursimet personale dhe të familjes.

5.2 Kjo hua dhe kthimi i saj është trajtuar në pikën 1 (pasuria apartament) të këtij vendimi.

6. Apartament me sipërfaqe 60 m²

6.1 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2017, të ZVRPP-së Lushnjë, konfirmohet se znj. Kaliona Nushi ka të regjistruar pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë apartament me sip. 60 m² (në bashkëpronësi).

6.2 Dokumentacioni për këtë pasuri apartament është përcjellë pranë Komisionit edhe nga ASHK Lushnjë më shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2023.

6.3 Rezultoi se kjo pasuri është blerë me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 26.8.1993, me palë blerëse G.N (babai i subjektit) dhe palë shitëse Komisioni i Privatizimit të Rrethit Lushnjë. Çmimi i blerjes rezultoi 5,220 lekë.

6.4 Sipas kartelës së pasurisë ky apartament është në bashkëpronësi midis shtetasve Kaliona, G dhe U.N, regjistruar në datën 15.3.1997.

6.5 Kjo pasuri apartament nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës, në deklarata periodike dhe as në deklaratën *Vetting*.

6.6 Për këtë është pyetur subjekti, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar: *“Pasi u njoha me konstatimin tuaj verifikova në sistemin e-albania, nga ku më rezultoi se unë figuroj bashkëpronare në pasurinë e sipërcituar. Sqaroj se kjo është një pasuri e blerë nga prindërit në vitin 1993, në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Sipas nenit 9 të këtij ligji: “Banesat që privatizohen do të regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij”. Në momentin e privatizimit të kësaj banese me kontratën e shitblerjes së datës 26.8.1993, të lidhur me Komisionin e Privatizimit të Rrethit Lushnjë, unë nuk kam qenë pjesëtare madhore e familjes dhe për këtë arsye ajo ka kaluar dhe është regjistruar në pronësi vetëm të prindërve të mi sipas certifikatës së pronësisë së lëshuar për këtë pasuri (gjëni bashkëlidhur dokumentacionin e cituar). Unë nuk kam qenë asnjëherë bashkëpronare e kësaj pasurie dhe as nuk mund të isha e tillë për shkak të ndalimit të nenit 9 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Edhe në vijim, asnjë nga pronarët e ligjshëm të kësaj pasurie (prindërit e mi) nuk kanë bërë ndonjë veprim për kalimin e ndonjë pjese të kësaj pasurie në emrin tim. Pasi informova prindërit e mi në lidhje me konstatimin tuaj, im atë ka bërë aplikim për kartelë të rifreskuar të pasurisë, por i cili kërkon kohën e nevojshme për t’u proceduar nga institucioni. Sapo të njihem me dokumentin përkatës do ju vë në dispozicion kopje të tij”.*

6.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka paraqitur një kopje të kartelës së pasurisë apartament me nr. pasurie ***, me adresë në Lushnjë. Sipas kësaj kartele të pasurisë së paluajtshme të lëshuar nga ASHK-ja (Drejtoria Vendore Lushnjë) rezulton se pronar dhe mbajtës i titullit të pronësisë për këtë pasuri apartament janë G dhe U.N (prindërit e subjektit).

6.8 Komisioni konstatoi se kjo pasuri është krijuar me anë të procesit të privatizimit në vitin 1993, shumë kohë para se subjekti të ushtronte funksionet e këshilltares (në momentin e privatizimit subjekti ka qenë 15 vjeçe).

6.9 Në përfundim të hetimit nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë pasuri.

7. Hetime të tjera

7.1 Komisioni hetoi në lidhje me pasuri të tjera të luajtshme e të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit.

7.2 Nga hetimi i kryer dhe të dhënat, si dhe dokumentacioni i mbledhur në dosje për këtë subjekt rivlerësimi nuk u konstatuan problematika apo pasuri të tjera për subjektin Kaliona Nushi.

7.3 Të dhënat janë marrë nga institucionet shtetërore dhe private si: AMF, ASHK, bankat, DPSHTRR, ISSH, TIMS, QKB, DPT, etj.

8. Analiza financiare për periudhën e rivlerësimit

8.1 Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit për periudhën gjatë detyrës së saj. Sipas kësaj analize rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer të gjitha veprimet financiare, pra për të krijuar pasuritë/likuiditetet, për të shlyer detyrimet dhe për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë periudhës së analizuar, sikurse është treguar në tabelën nr. 5.

Tabela nr. 5 – Analiza financiare për periudhën 1.4.2007 – 31.12.2016

Përshkrimi	nga 1.4.2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Pasuri	35,792	33,524	-24,137	-47,313	-1,342	227,561	-104,063	5,619	94,446	371,367
Apartament me sip. 43.8 m ² , rr. "****", TR, datë 2.2.2006										
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	35,792	33,524	-24,137	-47,313	-1,342	227,561	-104,063	5,619	94,446	371,367
Gjendja e likuiditeteve	35,792	69,316	45,178	-2,135	-3,477	224,084	120,020	125,639	220,085	591,451
Detyrimet	0	-	-	-	0	0	0	0	0	0
Hua marrë nga prindërit tek xhaxhai Gj.N										
Shlyerja e huas tek xhaxhai		-								
Kredi tek Credins Bank shuma 400.000 lekë për 2 vjet disb. 13.10.2008		400,000								
<i>Shlyerja e kredisë tek Credins Bank</i>		-14,164	-	-						
Kredi konsumatore tek ***/RZB 11.12.2008		102,800								
<i>Shlyerja e kredisë tek RZB</i>			-65,027	-37,773						
Pasuri Neto	35,792	144,888	244,520	172,665	-1,342	227,561	-104,063	5,619	94,446	371,367
Të ardhura dokumentuar	721,288	973,860	990,305	967,422	1,087,235	1,182,355	1,263,956	1,180,523	1,617,584	1,163,616
Të ardhura nga paga subjekti	721,288	973,860	990,305	967,422	1,087,235	1,182,355	1,181,583	1,180,523	1,168,948	1,163,616
Nga angazhimi si eksperte për reformën									428,440	
Pagesa nga pjesëmarrja në konferencë Kosovë							82,373			
Autore e shkrimit botuar në Revistën e Shk. Magjistraturës									20,196	
SHPENZIME	102,465	244,841	313,285	208,513	205,663	315,719	255,097	241,049	324,361	306,976
Shpenzime jetese	102,465	136,620	136,620	136,620	136,620	139,548	141,024	219,998	224,276	235,092
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS		0	41,837	13,881	29,043	12,088	14,073	15,412	0	0
Paguar interesa kredie në Credins Bank		5,421	48,978	13,600						
Paguar komisione kredie në Credins Bank			10,789							
Paguar për *** tek RZB Bank				2,137		104,084		5,639	100,085	70,778
Paguar Komisione dhe interesa bankare tek RZB		3,000	15,060	2,275						
Blerë TV tek *** npr RZB Bank		99,800								
Shpenzime mobilimi			60,000	40,000	40,000	60,000	100,000			
Shpenzime të tjera të evidentuara										1,106
Mundësia për kursime	583,031	584,131	432,501	586,244	882,914	639,075	1,112,923	933,855	1,198,778	485,274

8.2 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte burime të mjaftueshme për krijimin e pasurive/likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën e rivlerësimit.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit

9. Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, çmoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin e deklasifikuar plotësisht për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaramen për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

4. Me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2024 AKSIK-së i është kërkuar përditësimi dhe deklasifikimi i raportit të figurës së subjektit.

5. AKSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 25.4.2024, ka dërguar raportin e Grupit të Punës nr. *** prot., datë 31.10.2017, për kontrollin e figurës së subjektit Kaliona Nushi. Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 24.4.2024, të KDZH-së.

5.1 Bazuar në këtë raport konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Kaliona G Nushi.

6. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga AKSIK-ja ku konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit, Komisioni ka kryer hetim administrativ nga ku rezultoi se:

- nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës sipas dokumentacionit të administruar;
- nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit;
- nuk ka të dhëna implikuese me persona të përfshirë në veprimtari kriminale në lidhje me subjektin e rivlerësimit, referuar të dhënave të administruara;
- nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

7. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni për subjektin Kaliona Nushi nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

8. Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Raporti i vlerësimit profesional është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

3. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i) formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- ii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor;
- iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

4. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se:

- Formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa mangësi e kundërtënie, sipas shtojcës që parashikon ligji. Subjekti ka deklaruar të dhënat për periudhën gusht 2001 e deri aktualisht.
- Për periudhën prill 2007 e në vazhdim subjekti ka deklaruar se ushtron detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën Kushtetuese, detyrë të cilën e ushtron edhe aktualisht.
- Lidhur me të dhënat statistikore, subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi ka deklaruar se gjatë 3 viteve të fundit, 2014 – 2016, asaj i janë caktuar gjithsej 113 çështje, ka përfunduar gjithsej 116 çështje, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 6 çështje të vitit 2016. Këto të dhëna të deklaruara nuk dokumentohen me ndonjë shkresë nga Gjykata Kushtetuese.
- Subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që trajnohen nga Shkolla e Magjistraturës, por trajnimet dhe pjesëmarrja në aktivitetet e tjera shkencore janë bërë prej saj mbi baza vullnetare ose në ato të organizuara nga Gjykata Kushtetuese.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1. Relacion-opinion “Për shqyrtim në seancë plenare datë 16.12.2014”, për çështjen që i përket kërkuarit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, subjekte të interesuara Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë e Prokuroria e Përgjithshme, me objekt “Shfuqizim

si i papajtueshëm me Kushtetutën i togfjalëshit “dhe në doza të vogla”, në paragrafin e parë të nenit 283 të Kodit Penal”.

Në këtë relacion-opinion është sugjeruar nga këshilltarja Kaliona Nushi se ligjvënësi në parashikimin e nenit 283 të Kodit Penal ka respektuar kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës.

Relacion-opiniononi është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes; (ii) pretendimet e parashtruara gjykatës lidhur me dispozitën konkrete materiale; (iii) mendimi i këshilltarit për moskalimin për gjykim, me analizën e çështjes se në kushtet kur nuk ekziston asnjë akt ligjor apo nënligjor, i cili të përcaktojë se çfarë konsiderohet dozë e vogël, kjo rezulton nga interpretimi që i është bërë nga Gjykata e Lartë, por gjykatat e zakonshme gjatë interpretimit të dispozitës konkrete dhe zbatimit të saj rast pas rasti nuk kanë asnjë pengesë që ta interpretojnë atë dhe ta zbatojnë në përputhje me parimet kushtetuese, duke pasur parasysh elementet e veprës penale, llojin e lëndës narkotike të përdorur, etj. Relacion-opiniononi përbëhet nga 16 faqe, mban datën 15.7.2014, por rezulton i panëshkruar përbri emrit të këshilltares.

Lidhur me këtë çështje subjekti i rivlerësimit nuk kishte paraqitur vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të analizuar nëse është vendosur ose jo nga kjo gjykatë, sipas mendimit të këshilltares ligjore Kaliona Nushi.

Dokumenti 2. Relacion-opinion “Për shqyrtimin në seancë plenare datë 20.10.2015”, për çështjen që i përket kërkesit shoqëria “****” sh. a., subjekte të interesuar P.C dhe BKT Tiranë, me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. ***, datë 4.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nr. ***, datë 18.3.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. ***, datë 9.3.2015, të Gjykatës së Lartë”.

Në relacion-opinion është sugjeruar nga këshilltarja Kaliona Nushi se ka vend për diskutim në seancë plenare në lidhje me pretendimin e kërkesit për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykim.

Relacion-opiniononi është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja për kontratën e lidhur midis kërkesit dhe shtetasit P. C. për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet shtesë për pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme të një kompleksi turistik dhe ngjarjen e sigurimit të datës 30.10.2009, aktet administratave dhe vendimet gjyqësore objekt gjykimi; (ii) pretendimet e kërkesit lidhur me vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi; (iii) mendimi i këshilltarit për kalimin e çështjes për gjykim, duke analizuar mbi legjitimitimin e kërkesit në kuptimin formal dhe material, për cenimin e të drejtës së aksesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Relacion-opiniononi në 11 faqe gjithsej mban datën 12.11.2015, por nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit nuk kishte paraqitur vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të analizuar nëse është vendosur ose jo nga kjo gjykatë, sipas mendimit të këshilltares ligjore Kaliona Nushi.

Dokumenti 3. Relacion-opinion “Për shqyrtimin në seancë plenare datë 14.12.2016”, për çështjen që i përket kërkesit Sh.B.T.Sh, subjekte të interesuar Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, me objekt “Deklarimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 5 dhe 71, pika 2 e ligjit nr. 155/2015, datë 21.12.2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

Në relacion-opinion është sugjeruar nga këshilltarja Kaliona Nushi se në këtë rast nuk ndodhemi para cenimit të së drejtës së pronës, në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës dhe nuk konkludohet për cenim të parimit të sigurisë juridike nga kuptohet për rrëzim të kërkesës.

Relacion-opinion i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë ligji që kërkohet të shfuqizohet, nenet përkatëse dhe pika; (ii) pretendimet e kërkuarit dhe shkaqet që ka parashtruar si: është cenuar liria e veprimtarisë ekonomike, është cenuar e drejta e pronës dhe parimi i sigurisë publike. Pasi ka parashtruar edhe pretendimet e subjektit të interesuar, këshilltarja ka kaluar tek analiza e çështjes; (iii) analiza e çështjes lidhur me legjitimitimin e kërkuarit, lirinë e veprimtarisë ekonomike, të drejtën e pronës dhe parimin e sigurisë juridike. Në përfundim, është parashtruar mendimi i këshilltares se në këtë rast nuk ndodhemi para cenimit të së drejtës së pronës, në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës dhe nuk konkludohet për cenim të parimit të sigurisë juridike, nga kuptohet për rrëzim të kërkesës. Relacion-opinion i subjektit të rivlerësimit përmban 18 faqe, mban datën 9.12.2016, por nuk është i nënshkruar përbri emrit të këshilltares.

Lidhur me këtë çështje subjekti i rivlerësimit nuk kishte paraqitur vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të analizuar nëse është vendosur ose jo nga kjo gjykatë, sipas mendimit të këshilltares ligjore Kaliona Nushi.

Në përfundim të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime lidhur me përputhshmërinë e relacion-opinioneve të subjektit për këto 3 çështje, me vendimmarrjen e gjykatës, si dhe të paraqesë kopje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar në lidhje me përputhshmërinë e opinionit të saj me vendimmarrjet e Gjykatës Kushtetuese sipas tri dokumenteve ligjore të paraqitura prej saj në kuadër të procesit të rivlerësimit duke sqaruar se:

“Në lidhje me dokumentin 1, që i përket çështjes me kërkuese Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, evidentohet se: “Në këtë relacion-opinion është sugjeruar nga këshilltarja Kaliona Nushi se ligjvënësi në parashikimin e nenit 283 të Kodit Penal ka respektuar kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës”. Thënë kjo, në vlerësimin tim si këshilltare ligjore, pretendimi i ngritur nga gjykata referuese nuk dukej i bazuar.

*Në lidhje me këtë çështje, me vendimin nr. ***, datë 21.7.2015, Gjykata Kushtetuese ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi ka vlerësuar se: “Për të gjitha argumentet e paraqitura më sipër, Gjykata vlerëson se togfjalëshi “dhe në doza të vogla”, në paragrafin e parë të nenit 283 të KP-së, nuk bie ndesh me përmbajtjen e nenit 17 të Kushtetutës, për pasojë kërkesa e paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet” (paragrafi 30 i vendimit nr. ***, datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese, bashkëlidhur).*

Në lidhje me dokumentin 2, që i përket çështjes me kërkuese shoqëria “*” sh.a., me objekt “Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. ***, datë 4.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nr. ***, datë 18.3.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. ***, datë 9.3.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”.***

Në relacion-opinion është sugjeruar nga këshilltarja Kaliona Nushi se ka vend për diskutim në seancë plenare në lidhje me pretendimin e kërkuarit për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykim”. Thënë kjo, në vlerësimin tim si këshilltare ligjore pretendimi i ngritur nga kërkuari për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykim nuk dukej i pabazuar.

*Në lidhje me këtë çështje, me vendimin nr. ***, datë 23.2.2016, Gjykata Kushtetuese ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. ***, datë 9.3.2015, të Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka vlerësuar se: “... duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura nga kërkuesi, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës”. (paragrafi 23 i vendimit nr. ***, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese, bashkëlidhur).*

Në lidhje me dokumentin ***, që i përket çështjes me kërkuese Sh.B.T.Sh, evidentohet se: “Në relacion-opinion është sugjeruar nga këshilltarja Kaliona Nushi se në këtë rast nuk ndodhemi para cenimit të së drejtës së pronës, në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës dhe nuk konkludohet për cenim të parimit të sigurisë juridike, nga kuptohet për rrëzim të kërkesës”. Thënë kjo, në vlerësimin tim si këshilltare ligjore, pretendimi i ngritur nga kërkuesi nuk dukej i bazuar.

*Në lidhje me këtë çështje, me vendimin nr. ***, datë 27.1.2017, Gjykata Kushtetuese ka vendosur rrëzimin e kërkesës në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, pasi: “Në çështjen konkrete në shqyrtim asnjë nga argumentet e paraqitura nga kërkuesja për cenimin e parimeve kushtetuese nuk ishte i mjaftueshëm për t’u konsideruar në nivel kushtetues dhe nuk arriti të merrte shumicën e votave të gjyqtarëve të kërkuar nga ligji. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 73/4 të ligjit nr. 8577/2000 kërkesa konsiderohet e rrëzuar”. (paragrafi 18 i vendimit nr. ***, datë 27.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, bashkëlidhur)”.*

Bashkëlidhur, subjekti ka paraqitur të tria vendimet e Gjykatës Kushtetuese të përmendura më sipër.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me 3 dokumentet e paraqitura nga subjekti:

- Subjekti ka shpjeguar në mënyrë të qartë dhe të plotë arsyet e opinionit ligjor të dhënë si këshilltare ligjore dhe vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese.
- Në kuadër të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale nuk u konstatuan problematika lidhur me këto dokumente të zgjedhura nga subjekti i rivlerësimit.

Përshkrimi i 5 dokumenteve ligjore vëzhguara, të përzgjedhura me short

Dokumenti 1. Relacion-opinion i subjektit Kaliona Nushi, për çështjen civile të kërkuesve E.K. dhe E. A., me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën të Vendimit nr. ***, datë 22.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi”.

Opinionin “Për shqyrtimin në seancën plenare datë 16.7.2013”, i cili ndodhet i administruar në dosjen gjyqësore me nr. *** regj., datë 21.5.2013, të Gjykatës Kushtetuese, është i strukturuar në 3 pjesë.

Si konkluzion përfundimtar, subjekti ka shprehur mendimin se ky pretendim i kërkuesve është i bazuar dhe ka vend për pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Nga aktet në dosje rezulton se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. ***, shpallur më 22.1.2014 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës”.

Në rastin konkret mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, i cili është paraqitur në mënyrë jo të njëjtë me zgjidhjen që ka dhënë kjo gjykatë.

Lidhur me këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, në lidhje me dokumentin 1, që i përket çështjes me kërkues E. K. dhe E. A., subjekti ka shpjeguar në lidhje me mospërputhshmërinë e opinionit të saj me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, ku ka sqaruar se: *“Sa i përket kriterit të legjitimitimit racione materiae pretendimet e ngritura nga kërkuesi prima facie bënë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe se ato nuk ishin haptazi të pabazuara. Në lidhje me këtë çështje, me vendimin nr. ***, datë 22.1.2014, Gjykata Kushtetuese ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet e ngritura nga kërkuesit. Sjell në vëmendje se në këtë rast kërkuesi kishte ngritur disa pretendime në ankimin kushtetues.*

Për pretendimin për cenimin e parimit të gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj kam vënë në diskutim nëse qëndrimi i Gjykatës së Lartë përbënte tejkalim të kompetencave të saj ligjore, në kuptim të së drejtës për proces të rregullt. Në lidhje me pretendimin tjetër, atë për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim kam dhënë mendimin tim se ai ishte i bazuar. Pretendimi në atë rast konkret kishte të bënte me faktin se i njëjti gjyqtar i Gjykatës së Lartë që kishte dhënë vendimin e kundërshtuar, kishte marrë pjesë më parë në gjykimin ku kërkuesi ishte palë, si anëtar i trupit gjykues të Gjykatës së Lartë që kishte vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit. Për rrjedhojë, qëndrimi im është bazuar në këto fakte ashtu edhe në jurisprudencën kushtetuese, të cilën e kam referuar në opinionin tim ligjor.

Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka vendosur me shumicën e votave të gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes, çka nënkupton se pavarësisht vlerësimit dhe përfundimit të arritur prej saj, pretendimi i kërkuesve ka qenë i diskutueshëm në lidhje me bazueshmërinë e tij”.

Vlerësimi i Komisionit

Në kuadër të dhënies së opinionit ligjor nga subjekti për këtë çështje, në drejtim të aftësive profesionale, shpjegimet e paraqitura ishin të plota dhe bindëse.

Dokumenti 2. Relacion-opinion i subjektit Kaliona Nushi, për çështjen civile të kërkueses E.G., subjekte të interesuar AKKP, shoqëria “****” sh.p.k. dhe KRRT Bashkia Tiranë, me objekt: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. ***, datë 4.6.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 24.9.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. ***, datë 1.6.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”.

Opinionin “Për shqyrtimin në seancën plenare të datës 10.10.2013”, i cili ndodhet i administruar në dosjen gjyqësore me nr. *** regj., datë 19.7.2013, të Gjykatës Kushtetuese, është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja objekt gjykimi; (ii) pretendimet parashtruar Gjykatës Kushtetuese; (iii) analiza e çështjes, nga ku analizohet lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit.

Si konkluzion përfundimtar, subjekti ka shprehur mendimin se pretendimet e tjera të kërkueses kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe si të tilla nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

Nga aktet në dosje rezulton se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. ***, shpallur në datën 15.5.2014 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës”.

Në rastin konkret, mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, i cili është paraqitur në mënyrë të saktë dhe të njëjtë me zgjidhjen që ka dhënë kjo gjykatë.

Dokumenti 3. Relacion-opinion i subjektit Kaliona Nushi për çështjen penale të kërkuarit G.Y., subjekt i interesuar Prokuroria e Përgjithshme, me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. ***, datë 30.6.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr. ***, datë 22.1.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. ***, datë 30.5.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe gjithë vendimet gjyqësore të dhëna në bazë të procedimit penal nr. ***/***”.

Opinionin “Për shqyrtimin në seancën plenare të datës 16.9.2014”, i cili ndodhet i administruar në dosjen gjyqësore me nr. *** regj., datë 11.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese, është i strukturuar në 3 pjesë : (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; (ii) pretendimet – parashtruar Gjykatës Kushtetuese; (iii) analiza e pretendimeve.

Si konkluzion përfundimtar, subjekti ka shprehur mendimin se kërkesa ka vend për diskutim në drejtim të respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë.

Nga aktet në dosje rezulton se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. ***, shpallur në datën 26.2.2015 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës”.

Në rastin konkret, mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, i cili është paraqitur në mënyrë jo të njëjtë me zgjidhjen që ka dhënë kjo gjykatë.

Lidhur me këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, në lidhje me dokumentin *** që i përket çështjes me kërkuar G. Y., subjekti ka shpjeguar në lidhje me mospërputhshmërinë e opinionit të saj me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, ku, ka sqaruar se: *“Në lidhje me këtë çështje, me vendimin nr. ***, datë 26.2.2015, Gjykata Kushtetuese ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet e ngritura nga kërkuari. Sjell në vëmendje se, në opinionin tim për këtë çështje, është shtruar për diskutim nga Gjykata respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, bazuar në faktet e çështjes dhe standardet kushtetuese dhe ato të GJEDNJ-së. Gjykata edhe në këtë rast ka vendosur me shumicën e votave të gjyqtarëve, çka nënkupton se pavarësisht vlerësimit dhe përfundimit të arritur prej saj, pretendimet e kërkuarit kanë qenë të diskutueshme në lidhje me bazueshmërinë e tyre. Për më tepër, dua të sjell në vëmendje se, njëri prej gjyqtarëve në pakicë ka mbajtur qëndrimin se, kërkesa duhej të pranohet, pasi procesi ishte i parregullt pikërisht në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë”.*

Vlerësimi i Komisionit

Shpjegimet e paraqitura nga subjekti për këtë çështje ishin të mjaftueshme dhe bindëse për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar mangësi profesionale në përmbushjen e funksionit të saj si këshilltare ligjore.

Dokumenti 4. Relacion-opinion i subjektit Kaliona Nushi për çështjen me kërkuar “Një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, subjekte të interesuara Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën të paragrafit të 3 të nenit 5 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”.

Opinionin “Për shqyrtimin në seancën plenare të datës 3.5.2016”, i cili ndodhet i administruar në dosjen gjyqësore me nr. *** regj., datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese, është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen në mënyrë të qartë mosmarrëveshja objekt gjykimi; (ii) pretendimet parashtruar Gjykatës Kushtetuese; (iii) analiza e çështjes. Këshilltarja ka parashtruar se megjithëse Gjykata e Lartë e ka njohur këtë rregullim si rast përjashtimor për shkak të kompetencave që ushtron dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të kësaj gjykate, dispozita e kundërshtuar përbën tejkalim të normës kushtetuese, duke cenuar parimin e hierarkisë së normave, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në Kushtetutë.

Si konkluzion përfundimtar, subjekti ka shprehur mendimin se kërkesa e paraqitur nga jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit është e bazuar dhe duhet të pranohet.

Relacion-opinionin është i formatuar, përmban emrin e këshilltares dhe datën e përpilimit, më 28.4.2016. Ai përbëhet gjithsej nga 9 faqe, por nuk përmban nënshkrimin e subjektit.

Në relacion janë përshkruar faktet, është paraqitur ligji i zbatueshëm dhe paraqitet i argumentuar nga pikëpamja logjike. Në të është përdorur referenca në Kushtetutë, në ligjin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe është përdorur referencë në jurisprudencën e kësaj gjykate. Kërkuar dhe subjekti i interesuar kanë marrë përgjigje për pretendimet e identifikuar nga subjekti i rivlerësimit në relacionin e përpiluar.

Nga aktet në dosje rezulton se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. ***, shpallur në datën 27.7.2016 ka vendosur “Pranimi i kërkesës. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të paragrafit të 3 të nenit 5 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar me ligjin nr. 151, datë 30.5.2013”.

Në rastin konkret, mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, i cili është paraqitur në mënyrë të saktë dhe të njëjtë me zgjidhjen që ka dhënë kjo gjykatë.

Dokumenti 5. Relacion-opinion i subjektit Kaliona Nushi për çështjen penale të kërkuar M.M., me objekt “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. ***, datë 7.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, nr. ***, datë 13.11.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. ***, datë 4.11.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”.

Opinionin “Për shqyrtimin paraprak në kolegji”, i cili ndodhet i administruar në dosjen gjyqësore me nr. *** regj., datë 11.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese, është i strukturuar në 3 pjesë: (i) rrethanat e çështjes, ku pasqyrohen: dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për dënimin penal të kërkuar dhe pushimin e akuzës për veprën tjetër të akuzuar; dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë për lënien në fuqi të vendimit dhe dispozitivi i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit; (ii) pretendimet parashtruar Gjykatës Kushtetuese; (iii) analiza e pretendimeve, për të cilat është dhënë mendimi nga këshilltarja se kërkuar legjitimohet *ratione personale* në kuptim të neneve 131/f

dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Është vazhduar analiza lidhur me pretendimin *për cenimin e të drejtës së mbrojtjes në gjykim*, për të cilin këshilltarja ligjore ka parashtruar se nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton që gjykata e apelit i ka marrë të gjitha masat për njoftimin e kërkuarit dhe për të siguruar mbrojtjen në gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur. Pasi ka shtyrë gjykimin disa herë për shkak të mosparaqitjes së kërkuarit dhe mbrojtësit të zgjedhur dhe u është drejtuar organeve kompetente për njoftimin e tij, gjykata ka vendosur gjykimin në mungesë, por duke i garantuar atij të drejtën e mbrojtjes nëpërmjet mbrojtësit të caktuar kryesisht. Këshilltarja ka dhënë mendimin se për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar. Lidhur me pretendimin e kërkuarit *për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit*, këshilltarja ligjore ka parashtruar se parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kërkuari nuk ka arritur të provojë se thirrja e ekspertëve ka pasur rëndësi të tillë për çështjen, në kuptimin që mungesa e tyre në gjykim e bën vendimin jokushtetues. Sa i përket pretendimit tjetër të kërkuarit, atë për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, pasi kjo gjykatë në lidhje me shkeljet kushtetuese, e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, pa thirrur palët në gjykim, duke vendosur mospranimin e rekursit, këshilltarja ka parashtruar se veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është shkelje e të drejtës së palëve për t’iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që parashikon ligji, duke lënë jashtë për zgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Bazuar në këto standarde, këshilltarja ka dhënë mendimin se kërkuari e ka ushtruar lirisht të drejtën e aksesit nëpërmjet rekursit në Gjykatën e Lartë.

Si konkluzion përfundimtar, subjekti ka shprehur mendimin se duhet të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Nga aktet në dosje rezulton se Kolegji i Gjykatës Kushtetuese me vendimin nr. ***, shpallur në datën 1.7.2016 ka vendosur “Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare”.

Në rastin konkret, mendimi i këshilltares për mënyrën e përfundimit të çështjes është dhënë në formën e një konkluzioni, i cili është paraqitur në mënyrë të saktë dhe të njëjtë me zgjidhjen që ka dhënë kjo gjykatë.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

5. Për subjektin e rivlerësimit Kaliona Nushi nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit, për shkak të detyrës që ajo ka ushtruar në këtë periudhë si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese.

Analiza e gjetjeve

6. Subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi ka shfaqur aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën kushtetuese, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit – këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese.

7. Në tri dokumentet ligjore të deklaruara si të përzgjedhura, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të analizuar nëse është vendosur ose jo nga kjo

gjykatë, sipas mendimit të këshilltares ligjore Kaliona Nushi. Në pesë dokumentet ligjore të shortuara është konstatuar se në dy dokumentet, konkluzioni i këshilltares nuk ka qenë i njëjtë me zgjidhjen që i ka dhënë gjykata mosmarrëveshjes.

8. Nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Kushtetuese, mbi bazën e të cilave u përzgjedhën dhe 5 dokumentet ligjore rezulton se këshilltarja ligjor Kaliona Nushi ka hartuar akte të relativitetit për 108 çështje me natyrë kushtetuese.

9. Duke iu referuar nenit 6/1 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës Kushtetuese “Mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës”, për sa i përket aspektit kohor, këshilltari ligjor i gjyqtarit relator duhet të vërë në dispozicion të gjyqtarëve të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese materialin e përgatitur prej tij të paktën 2 ditë përpara seancës. Në analizën e këtyre të dhënave për të konkluduar mbi aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë duhet evidentuar edhe fakti se kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për këshilltarin ligjor të Gjykatës Kushtetuese në aspektin sasior. Nisur nga analiza më sipër, arrihet në konkluzionin se nga këshilltari ligjor pothuajse është zbatuar afati kohor, duke përjashtuar vetëm tri rastet kur opinionet e deklaruara nga ky subjekt nuk përmbanin bashkëlidhur vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

10. Nga të gjitha praktikat e administruara ka dokumentim të veprimeve të kryera nga këshilltari ligjor që shfaqet në formën e opinionëve apo materialeve shtesë studimore. Nga përmbajtja e 8 dokumenteve ligjore konstatohet se në çdo rast, nga këshilltari ligjor është bërë pasqyrimi i detajuar i rrethanave të çështjes, pretendimet parashtruar para Gjykatës Kushtetuese, si dhe analiza e çështjes, në të cilën evidentohen pretendimet e ngritura nga kërkuesi e të cilat analizohen në frymën e gjyqimit në nivel kushtetues prej subjektit, bazuar në normat kushtetuese, ligjin për Gjykatën Kushtetuese, praktikën e kësaj gjykate dhe GJEDNJ. Në dokumentet ligjore evidentohet përdorimi i parimeve të përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe analizë apo referim në jurisprudencën përkatëse në rastet e raportuara. Këto veprime ajo i ka materializuar në opinionin ligjor, duke plotësuar gjithmonë elementet procedurale, datën e përpilimit të aktit, siç kërkohet në nenet 6/1, 10/1, a, 12/1 dhe 27/2, 3 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës Kushtetuese “Mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës”.

11. Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 8.3.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, është konfirmuar se subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi nga data e emërimit 1.4.2007 e në vijim nuk ka kryer asnjë shkelje të etikës dhe nuk ka marrë asnjë masë disiplinore në ushtrimin e funksionit të saj si këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese.

12. Nga dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi dhe nga 5 dokumentet ligjore vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

13. Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 opinionet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Kaliona Nushi.

14. Në asnjë prej opinionëve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese pranë të cilit ka ushtruar detyrën e këshilltares ligjore apo me trupën gjyquese të Gjykatës Kushtetuese nuk janë konstatuar vonesa në relativitetin e çështjes që të ketë sjellë problematikë në gjykimin e çështjes në seancën e shqyrtimit paraprak apo seancën plenare, kjo edhe për faktin se praktika e punës

në këtë gjykatë dhe veprimet e këshilltarit ligjor me dosjet përkatëse nuk evidentohen në regjistra për të matur parametrat e shpejtësisë dhe të sasisë në punë.

15. Subjekti i rivlerësimit ka fituar titullin *Master i Shkencave në Legjislacion dhe Institucionet Europiane* nga U.T, lëshuar në datën 14.11.2014.

16. Subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi nuk është subjekt që trajnohet nga Shkolla e Magjistraturës, por megjithatë ajo ka marrë pjesë në 9 trajnime dhe aktivitete ndërkombëtare jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, që u përkasin tri viteve të fundit, çka lidhet me thellimin e njohurive të saj në fushën e të drejtës kushtetuese dhe të drejtës civile.

17. Sipas listave bashkëlidhur vendimit nr. ***, datë 21.5.2018, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës dhe të shpallura nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Vlerësimit Elektronik (faza e parë) dhe Komisioni i Vlerësimit të Testit Profesional (faza e dytë), këshilltarja ligjore e Gjykatës Kushtetuese Kaliona Nushi rezulton se ka marrë në total 157 pikë.

18. Për sa më sipër nuk u konstatuan problematika lidhur me 3 dokumentet ligjore dhe 5 dokumentet ligjore të vëzhguara, të përzgjedhura me short për subjektin e rivlerësimit.

DENONCIME

19. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Kaliona Nushi nuk janë administruar denoncime nga publiku.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

20. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi ka treguar cilësi të mira në punën e saj, si dhe është efiçente dhe efektive dhe konsiderohet “e aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Kaliona Nushi ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kaliona Nushi, këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.5.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Genta Tafa (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi